



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORI

Nr. 808 Prot.

Tiranë, më 24 04 .2026

URDHËR

Nr. 11 dt. 24 .04 .2026

“PËR

**HAPJEN E THIRRJES PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË  
CIKLIT TË TRETË DOKTORATË NË "SHKENCA SPORTIVE" DHE  
"AKTIVITETI FIZIK DHE SHËNDETI", PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026, NË  
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS**

Mbështetur ne Ligiin Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Keshillit të Ministrave, Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për percaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademike "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 dhe Udhëzimin Nr. 7, datë 31.3.2021, Për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë", në nenin 16 të Rregullores "Për organizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në Universitetin e Sporteve të Tiranës, në zbatim të Urdhërave të MAS, Nr.95, datë 25.2.2022 dhe Nr.98, datë 25.2.2022, "Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në "Shkenca Sportive" dhe "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti"; ne vijim të shkresës së Ministrisë së Arsimit "Kthim Përgjigje" me nr. 113/3 Prot., datë 03.04.2026 (e regjistruar në UST me nr.59/7 Prot., datë 07.04.2026),

URDHËROJ:

1. Hapjen e thirrjes për pranimet në programet e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në:
  - "Shkenca Sportive" në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes.
  - "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit.
2. Apikimet e kandidatëve për studimet e ciklit të tretë "Doktoratë" në Universitetin e Sporteve të Tiranës do të kryhen nga data 04.05.2026 deri më datë 04.06.2026.
3. Ky Urdhër i përcillet Njësive Kryesore të UST-së, si dhe Dretorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASA



Rr. Muhamet Gjollësja, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al